



FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN RAJONE PËR ADMINISTRIMIN E GJYKATAVE DHE MENAXHIMIN E ÇËSHTJEVE

11 nëntor 2019

Kur Prezenca e OSBE-së zhvilloi një studim për efikasitetin e proceseve gjyqësore, në vitin 2013, rezultatet ishin vërtet tronditëse. Thujse gjysma e seancave të vëzhguara ishin tërësisht joproduhese: asnjë palë nuk paraqiste argumente, nuk vihej në dispozicion asnjë dokument, nuk jepej asnjë provë.

U duk qartë se nevojiteshin hapa të rëndësishëm dhe vendimtarë për të përmirësuar produktivitetin e sistemit.

Projekti “Drejtësi pa vonesa”, i zbatuar nga Prezenca dhe i financuar nga qeveria austriake, qe një përgjigje ndaj kësaj situate. Ai synon të përmirësojë efektshmërinë e procedurave në të gjitha gjykatat në Shqipëri.

Projekti ka qenë dhe mbetet një sukses i madh dhe i matshëm. Po ju jap tre shembuj:

- Në gjykatën e Krujës, vetëm gjashtë muaj pas fillimit të projektit “Drejtësi pa vonesa”, kohëzgjatja mesatare e gjyqeve penale u ul nga 135 ditë në më pak se 45 ditë. Secili prej gjyqtarëve e dyfishoi numrin e çështjeve, gjatë kësaj kohe;
- Në Korçë, numri i seancave joproduhese në çështjet civile ra nga 35% në 2%;
- Në Lezhë, numri mesatar i seancave u ul me gati 50%.

Këta shembuj janë vetëm tre prej historive të shumta të suksesit. Në mbarë vendin, punonjësit e gjykatave po vënë në jetë rekomandimet procedurale. Ata e kuptojnë vlerën e misionit të tyre: t’i japin drejtësi të vërtetë dhe pa vonesë çdo personi, pavarësisht gjinisë, moshës, etnisë, pushtetit politik, pasurisë apo faktorëve të tjerë. Ligji është i barabartë për të gjithë. OSBE-ja është gjithmonë në mbështetje të këtij parimi bazë.

Por, lejomëni të jem i qartë: Mbetet akoma shumë punë për të bërë.

Për të siguruar një sistem drejtësie të drejtë dhe të efektshëm, ka edhe nisma të tjera, që po ecin paralelisht. Të gjithë e dimë ndryshimin të cilit po i nënshtrohet sistemi i drejtësisë në Shqipëri.

- Vetting-u i punonjësve të drejtësisë vijon, ndërsa Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë, me shpresë, do të jenë funksionale së shpejti;
- Do të ngrihen organe të reja kundër korrupsionit si SPAK-u.

Këto përpjekje janë reforma të domosdoshme për të forcuar gjyqësorin shqiptar dhe për të rritur besimin e qytetarëve shqiptarë në sistemin e gjykatave.

Prezenca e OSBE-së mbështet organet qeverisëse të gjyqësorit dhe gjykatat e rretheve në këto përpjekje.

Mbështesim, me kënaqësi, punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe bashkëpunimin mes autoriteteve vendore dhe shkëmbimet e përvojës. Këto ofrojnë mundësi për shkëmbimin e praktikave të mira në të gjitha nivelet. Theksi, në këto bashkëpunime, është rritja e kapaciteteve të Këshillit, Shkollës së Magjistraturës dhe gjykatave të rretheve.

Të gjitha këto përpjekje do të ishin të pamundura pa bashkëpunimin e ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë. Për veprimtarinë e sotme, do të doja t'u shprehja mirënjohjen time Këshillit të Lartë Gjyqësor, USAID-it, Këshillit të Evropës, Shkollës së Magjistraturës dhe kolegëve tanë, që punojnë në fushën e shtetit të së drejtës në misionet e OSBE-së në rajon. Shpreh vlerësimin tim të sinqertë për ambasadën austriake dhe Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim, që bënë të mundur këtë veprimtari.

Konferencat si kjo e sotmja janë një mundësi e çmuar për të bashkërenduar përpjekjet e organizatave ndërkombëtare për të ndihmuar Shqipërinë dhe rajonin që të zbatojnë standardet më të mira ndërkombëtare në fushën e drejtësisë. Këto standarde nuk janë koncepte abstrakte: ato ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve të këtij vendi.

Po e mbyll fjalën time duke ju uruar një ditë frytdhënëse dhe interesante. Faleminderit për vëmendjen!